



Chr. 21 Prot

## Permbledhje joteknike e aktiviteteve

*“Miniere nentokesore”*

**ID. 3.6** Minierat nentokesore dhe veprimtarite e lidhura me to



**Subjekti:** “Sara Albartia” sh.p.k

**Hartoi:** “EKO-STUDIO-PROJEKT” sh.p.k

**Administrator:** SHKEIZER MADANI



Tirane, 2022



## **PERMBAJTJA**

- Hyrje
- Baza ligjore
- Metodika e vleresimit te mjedisit
- Objektivat dhe qellimi i VNM-se

**1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

**2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

**3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVENE MJEDIS**

**4. MASAT PER ELEMINIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**

**5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**





## HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre tepashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proçes. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qeeshtebere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdonimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfera, perdonimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

## BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit nezbatim teakteveligjoredhe nenligjoreMjedisore:

- *Ligi Nr.10 431,date 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligi nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligi nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit neMjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes sekuqeteflores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelinkufi tezhurmave nemjedise te caktuara”*
- *Ligi nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligi nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligi nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimitarive qe ndikojne ne mjesdis per te cilat kerkohet leje mjesdisore »*
- *Liqj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjesdisore per te siguruar pjese marrjen e publikut dhe te OJF-ve mjesdisore ne procesin e vleresimit te ndikimit nemjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per lejemjedisi tetipave A,Bdhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shyrtimin e tyre nga autori te te kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te perjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjesdis”.*



## **1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

### **➤ Profili i propozuesit**

#### **1. Operacioni shpim-plasjes:**

Sistemi I shfrytezimit I mineralit te kromit eshte zgjedhur sistemi me galeri nenkati me hapesira te hapura. Gjatesia e bllokut 25-30 m. Lartesite e katit 20-30 m me lartesi katit 6-7 m.

Parametrat kryesore te punimeve horizontale:

- Seksioni I punimit 3.6 m<sup>2</sup>
- Nr.i birave 13
- Thellesia e birave 1.2 ml
- Koeficenti I shfrytezimit te bires 0.8
- Hapja e avancimit 1ml
- Konsumi specifik 2.3kg/m<sup>3</sup>
- Lloji I lendes plaseze dinamit
- Lloji I kapsollave te zakonshme
- Nr I kapsollave: 13
- Metrazhi I fitilit: 27 m
- Volumi I materialit: 5.5 m<sup>3</sup>

Procesi kryesor I prodhimit te mineralit te kromit kalon ne 3 procese kryesore:

1. Procesi I shpimit
2. Procesi I mbushjes dhe ekplodimit te lendes plaseze
3. Procesi I ngarkimit dhe transportit te materialit te rreziuar

Varianti me optimal per shfrytezimin dhe hapjen e punimeve do te jetë perdorimi I shpimit me bira me metoden tradicionale. Birat do te behen me cekic shpues 7655 tip kinez qe perdoren ne te gjitha minierat tona. Shpimi I birave do te behet me diameter 38-42 mm, dhe me thellesi 1.1-1.2 ml ne punimet minerare dhe 2.5 m ne fund te shfrytezimit sipas pashaportave te shpim-plasjes.

#### **2. Operacioni i prodhimit dhe transportit te mineralit nga nentoka ne siperfaqe**

Ngarkimi I materialit ne frontet e avancimit te nenkateve do te behet me lopate ne llamarinen e shtruar ne fronting e ngarkimit. Ngarkimi I mineralit dhe sterilit do te jetë I thjeshte me lopate dore. Ndersa ne pikat e ngarkimit te prodhimit ngarkimi do te behet me lopate vetngarkuese. Si mjet transporti do te jetë vagoni me kapacitet 0.6 m<sup>3</sup> me kosh te kthyeshem. Transporti per ne sheshet e depozimit do te kryhet nga dy punetore (vagonista). Sterili do te depozitohet ne hapesirat e shfrytezuara me pare (Hz +506) profili 10-11, ndersa minerali I kromit do te transportohet me krah deri tek oborri I dishenterise nr.3 dhe qe andej nepermes organelles do te nxirret ne siperfaqe dhe do te depozitohet ne stivat e percaktuara ne siperfaqe. Materiali I depozituar ne siperfaqe (kromi), do te transportohet per destinacion eksporti, nepermes mjeteve te shoqerise.

#### **3. Operacioni i heqjes se ujerave nentokesore**

Largimi I ujerave nga miniera ne punimet horizontale do te behet nepermjet kanaleve anesore me pjerresi 5-7%, ne drejtim te daljes ne siperfaqe, ndersa heqja e ujerave ne punimet e



pjerreta (dishenteria 3 dhe 4) do te behet nepermjet stacioneve te pompimit te intaluara ne horizontin +472 dhe Hz +506 deri ne siperfaqe.

4. Operacioni i ajrimit te gjithe minieres, i cili behet ne menyre natyrale pasi miniera eshte e lidhur me siperfaqen.

Gjatesite e vogla te punimeve te hapjes, lidhja e tyre me hapesirat e shfrytezimit si dhe fakti qe nuk do te happen punime te pjerreta apo vertikale te gjatesive te medha gjate ketij aktiviteti e bejne te lehte dhe pa probleme ajrimin e fronteve per depression natyral. Punimet minerare te hapura me difference kuotash bejne te mundur kalimin e rrymave te ajrit nga nivelet e poshtme te punimet ne nivelet e mesiperme dhe anasjelltas. Ajri I paster do te futet nepermjet dishenterise nr.3 dhe Hz +506 (galleria e transportit), dhe do te dale ne galerine nr.2 (Hz +573).

## **2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

### **3.1 Pozita gjeografike**

Bajram Curri eshtë territor në veri të [Shqipërisë](#). Ai bën pjesë në Rrethin e Tropojës. Si njësi administrative ajo përfshihet në [qarkun e Kukësit](#). Qyteti i Bajram Currit eshtë qëndra më e rëndësishme administrative dhe funksionale e rrëthit te Tropojës. Qyteti rrëthohet nga disa fshatra te komunës Margegaj. Në veri ai kufizohet me fshatin Margegaj, në lindje me fshatin Paqe, në jug dhe perëndim me fshatin Fushë-Lumi. Ndërsa si komuna fqinje në veri kufizohet me komunen Margegaj, në verilindje me komunën Tropoje, në jug me komunën Llugaj dhe Bujan. Qyteti i Bajram Currit ka një sipërfaqe prej 165ha, në të cilën jetojnë 8500 banorë. Dendësia mesatare e popullsisë eshtë 27b/km<sup>2</sup>.

Zona të njoitura eshtë [lugina e Valbonës](#) dhe zona e Alpeve. Qyteti i Bajram Currit eshtë qëndra kryesore administrative e Tropojës, ku eshtë për qëndruar numri më i madh i popullsisë, në krahasim me komunat përreth si dhe ka një zhvillim social-ekonomik të bazuar në sektorin e shërbimeve.

#### Veçoritë litologjike

Gjeologjikisht rrathi i Tropojës, ku bën pjesë dhe qyteti i Bajram Curri, shtrihet ne kontaktin e përplasjeve të 3 zonave tektonike:të zonës së Mirditës , zonës së Alpeve dhe të zonës së Cukslit dhe me thyerjen e madhe tektonike [Shkodër–Pejë](#).

Formacionet gjeologjike që ndërtojnë truallin e kësaj zone janë të larmishme dhe të shumëllojshme si sedimetarë, magmatikë, metamorfikë të llojeve të ndryshme, me të cilat lidhen pasuritë e shumta minerale nëntokësore të cilat ndihmojnë sadopak në zhvillimin social – ekonomik të të gjithë rrëthit. Me shkëmbinjtë magmatikë të cilët përfaqësohen nga peridotide që kanë ngjyrë jeshile lidhet me mineralin e kromit. Të dy llojet e shkëmbinjëve favorizojnë që rrathi i Tropojës të zhvillojë industrinë e nxjerrjes së mineralete të kromit. Shkëmbinjtë magmatik dhe gëlqerorë jamë më të përhapurit në të gjithë territorin e qytetit të Bajram Currit.



### Veçoritë morfologjike


Qyteti i Bajram Currit shtrihet në gropën e Tropojës, e cila është gropë me shtrirje me të madhe në veri të Shqipërisë. Ajo ka një relief relativisht të butë dhe lartësi që varijojnë nga 200-700-800 m mbi nivelin e detit. Formimi i kësaj grope lidhet me përplasjen e tri zonave tektonike (Mirditë, Alpe dhe Cukal) dhe me thyerjen e madhe tektonike Shkodër-Pejë. Ajo përbën një graben të ri, i cili për një kohë të gjatë ka qënë i zënë nga një liqen, prania e të cilit dëshmohet nga qymyret dhe depozitimet argjilore. Në këtë liqen derdhej edhe Valbona me degët e saj. Pjesa më e madhe e liqenit është në Cërnicë, ku edhe trashësia e argilit është më e madhe. Tharja e liqenit lidhet me erozionin regresiv të ndonjë dege të Drinit, që pasi thau liqenin, tërroqi me vete rrjedhjet ujore duke formuar kështu rrjedhjen ujore të lumit të Valbonës. Në këtë proces kanë ndikuar edhe lëvizjet ngritëse, që vazhdojnë edhe sot. Për pasojë Valbona dhe degët e saj kane coptuar siperfaqen e kësaj grope. Levizjet ngritëse janë zhvilluar të ndërthurura me periudha qetësie relative, që është shoqëruar më formimin e 2-3 nivele taracash erozive-akumuluese që në dalje të Valbonës dhe Gashit në gropën e Tropojës, ndërthuren me kodrinat moranike. Copëtimi horizontal i reliefit të saj është i madh sidomos në shpatin perëndimor. Vlerat më të vogla takohen në sipërfaqet e pakta të sheshta të kësaj grope. Energjia e reliefit merr vlera që lëkunden nga  $50-100 \text{ m/km}^2$  në pjesën fundore, në mbi  $300 \text{ m/km}^2$  në pjesën veriore të saj. Gropa e Tropojës është asimetrike: shpati perëndimor i përbërë nga flishi në pjesën e poshtme, është më i lartë dhe më i copëtuar se ai lindor, verior dhe jugor shumë të thepisuara kryesisht gëlqerorë. Qyteti i Bajram Currit rrethohet nga majë e kreshta të larta dhe lugina të thella lumore. Këtu mund të përmendim kurrizin **Toplanë-Bosh dhe majë e Hekurave** në pjesën perëndimore, lugina e **Nikaj-Currat** në lartësi nga 140 m deri në 1200–1300 m, **lugina e Valbones** në veri, etj.

### Veçoritë e klimes

Bajram Curri bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare paramalore dhe malore me ndikim kontinental. Klima karakterizohet nga një dimër i ftohtë dhe verë e freskët dhe e thatë. Kjo lidhet me ndikimin e fuqishëm të erërave të forta që vijnë nëpërmjet qafës së Morinës dhe te Pejës nga Rrafshi i Dukagjinit. Temperatura mesatare e janarit arrin në rreth  $1^\circ\text{C}$ , ndërsa ajo e korrikut në  $22^\circ\text{C}$ . Temperatura mesatare vjetore është rreth  $11.9^\circ\text{C}$ , ndërsa temperatura minimale e regjistruar deri tanë është  $-22^\circ\text{C}$ . Reshjet bien në formë shiu dhe në formë bore. Reshjet janë të shpërndara në mënyrë të çrrëgullt, ku bien rreth 1450mm/vit. Sasia e reshjeve mesatare arrin në 1700mm. Ato në formë bore në disa zona të veçanta shkojnë deri në 2-3m si rasti i vitit 1985. Bora zgjat nga fund i vjeshtës në interval deri nga fillimi i pranverës. Po t'i analizojmë këto elemente klimatike del se kjo shumëlojshmëri klimash e favorizon zhvillimin social-ekonomik te zonës.

Temperaturat maksimale të ajrit në gradë celcius në qytetin e Bajram Currit sipas muajve.

Muaji	janar	shkurt	mars	prill	maj	Qeshor	korrik	gusht	shtator	totor	nëntor	dhjetor	vjetore
B.Curri	0,3	2,4	6,1	11,8	16,1	20	22,2	22,4	18,2	12,4	7,8	3,1	11,8



Temperat minimale të ajrit në gradë celcius në qytetin e Bajram Currit sipas muajve

Muaji	J	Sh	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH	V
B.Curri	-18,7	-17,9	-13,0	-2,8	0,3	4	6,9	6,4	3,3	-2,0	-14,8	-16,4	-18,7

#### Veçoritë hidrografike

Qyteti i Bajram Currit bën pjesë në pellgun ujëmbledhës të Valbonës, i cili është lumi më i gjatë i Alpeve shqiptare dhe ushqimi kryesor i saj është shkrirja e borës. Pavarësisht se lumi i Valbonës nuk kalon në territorin administrativ të qytetit të Bajram Currit atë e përshkojnë 3 degët e tij të rëndësishme që janë: përroi i Shudenicës, përroi i Janës si dhe një degëzim i Janës si dhe një degëzim i Shudenicës. Gjithashtu janë të pranishme dhe disa burime ujore sipërfaqësore, të cilat shërbejnë dhe përfurnizimin me ujë të pijshëm ashtu dhe përvaditje në disa zona në periferi të qytetit

#### Veçoritë e tokave

Përsa i përket llojit të tokave ato janë të shumëllojshme të kafejta dhe të hirta kafe si dhe të murrme pyjore dhe aluvionale më në veri të qytetit, të cilat i përkasin luginës së Valbonës. Në tokat e kafenjta kultivohen bimet e arave, drufrutoret, perimet, të cilat shtrihen në pjesën periferike të qytetit. Shkalla e degradimit në zona të veçanta paraqitet e lartë sepse u hapen toka në pjerrësi deri në  $10^{\circ}$ , gjë që shkakton degradim të tokës të shkaktuar nga faktori antropogen dhe me pas nga ai natyror. Pjesa më e madhe e sipërfaqes është e zënë nga ndërtimet dhe vetëm në pjesën periferike vihen re kultivimi i kulturave drufrutore ashtu dhe të tokave bujqësore.

#### Veçoritë e biodiversitetit

Diferencimet e mëdha mbi nivelin e detit, në mes të zonës fushore 250m me asaj malore mbi 2000m, majave shumë të larta, luginave shumë të thella, ekspozimit të shpateve ndaj rrezatimit diellor, përbërjes së shkëmbinjve, burimeve të shumtë ujore dhe mikroklimave që krijojnë kushte ideale për shumëllojshmërinë e specieve bimore. Për vlerat e larta që ka biodiversiteti një përqindje e konsiderueshme e specieve bimore janë bimë endemike. Qyteti i Bajram Currit ndodhet në brezin e pyllit të lisit. Në pjesën veriore të qytetit ndosdhet "Pylli i Gështenjës" me një sipërfaqe 2600 ha. Janë të pranishme katër i dushqeve dhe pjesërisht i ahut më në periferi. Një e vecantë për këtë zonë është se një pjesë e banorëve që jetojnë në qytet, bejnë një jetë të dyfishtë në mes dy botëve: ajo nga qershori në shtator dalin ne bjeshkë për mbledhjen e bimëve mjekësore që sigurojnë një pjesë të të ardhurave dhe



pjesa tjetër në zonën fushore(qytet) në periudhën shtator-maj. Fauna përfaqësohet nga disa lloje kafshësh dhe shpendësh të egrë që jetojnë në brendësi të pyllit dhe të masiveve të gështenjave në periferi të zonës së qytetit.

Vlerësimi i kushteve natyrore (resurseve natyrore). Pozita gjeografike si dhe kushtet natyrore në të cilat ndodhet qyteti i Bajram Curri ofrojnë kushte të mira të zhvillimit social dhe ekonomik të zonës.Kushtet natyrore në të cilat ndodhet qyteti,vendosja në një relief relativisht të rrafshët,me një klimë më të zbutur në krahasim me komunat e tjera përreth , rrjeti i pasur hidrik si dhe puna e tokave të kafenjta dhe të hirta kafe , ofrojnë mundësi zhvillimi si të sektorëve të shërbimeve ashtu dhe të sektorit të bujqësisë në zonën periferike të qytetit. Gjithashtu prania e një sipërfaqe të konsiderueshme të pyllit të gështenjës ofron mundësi të gjenerimit të të ardhurave nëpërmjet tregtimit.

### **3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

Çdo aktivitet qe zhvillohet shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis, qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per tu zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitisht ndikimet e cdo operacioni te kryer.

#### **NDIKIMET NEGATIVE NE MJEDIS**

- **Ndikimet ne toke**

Gjate zhvillimit te aktivitetit gjenerohen mbetje te ngurte sterile. Transporti per ne sheshet e depozimit do te kryhet nga dy punetore (vagonista). Sterili do te depozitohet ne hapesirat e shfrytezuara me pare (Hz +506) profili 10-11, ndersa minerali I kromit do te transportohet me krah deri tek oborri I dishenterise nr.3 dhe qe andej nepermes organelles do te nxirret ne sipërfaqe dhe do te depozitohet ne stivat e percaktuara ne sipërfaqe. Materiali I depozituar ne sipërfaqe (kromi), do te transportohet per destinacion eksporti, nepermes mjeteve te shoqerise.

Persa i perket mbetjeve urbane te cilat jane mbetjet e gjeneruara nga stafi i punojsve keto do te grumbullohen ne vendet e percaktuarar nga subjekti per tu derguar me pas ne vendet e percaktuara nga pushteti vendor

- **Ndikime ne uji**

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk ndikohen ujerat nentokesore apo sipërafaqesore. Ujrat e gjeneruar nga shfrytezimi ne miniere kalojne ne ujembledhesin e minieres prej andej uji kalon ne gropen dekantuese per dekantimin e sterileve dhe me pas largohet me ane te pompes.

Ujrat per nevoja te stafit, per kryerjen e nevojave personale sigurohet nga Ujesjelles kanalizime.Ujrat e gjeneruar nga perdorimi i tualeteve nga stafi do te shkarkohen ne rrjetin e kanalizimeve.



- **Ndikime ne ajer**

Miniera ne fjale eshte miniera ekzistuese, qe punon prej disa dekadas, e ndikime ne ajer nuk ka.

- **Ndikime ne flore dhe faune**

Duke qene nje miniere ekzistuese, dhe me nje leje mjedisore te meparshme, nuk do te kete ndikime ne flore e faune.

## **MASAT PER ELEMINIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte:

### **Masat e marra për zvogëlimin e impaktit ne mjedis**

- ***Emetimet ne ajer***

Gazet prej mjeteteve te punes jane ne intervale kohore te shkurtra, brenda normave te lejuara pa ndonje ndikim negativ ne mjedisin perreth. Nga shoqeria behet vazhdimesht sperkatja e rrugeve me uje nepermjet sistemit te sperkatjes.

- ***Trajtimi i mbeturinave te ngurta***

Mbetjet qe dalin nga nxjerrje e mineraleve metalore, sterile te tjera si dhe mbetje pluhurash riperdoren serish nga subjekti per rehabilitimin e objektit minerar ndersa mbetjet urbane te gjeneruara si leter, karton qelq grumbullohone dhe transportohen ne vendepozitimin e Njesise Vendore.

- ***Rastet aksidentale***

Jane marre masat per parandalimin e tyre, mjetet kontrollohen vazhdimesht per gjendjen teknike te tyre ne menyre qe te mos kemi rrjedhje lubrifikante apo karburant. Shoqeria siguron se do kete nderhyrje te menjehershme nese do te kete ndikime negative ne mjedis. Gjithashtu zbatohen me perpikemeri te gjitha rregulloret e mbrojtjes nga zjarri.

- ***Kushtet e punes***

Persa i perket sigurimit teknik te punonjesve ata jane te mire informuar mbi rregullat e sigurimit teknik gjate kryerjes se punes, konform rregulloreve perkatese per mbrojtjen e jetes dhe shendetit. Gjithashtu shoqeria i ka pajisur me uniforma dhe mjete mbrojtse. Vendet qe paraqesin rrezik kane te mbishkruara edhe tabela ku duhet te tregohet kujdes nga personeli.



### **Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune**

#### ➤ **Detyrat e subjektit qe do te zhvilloje aktivitetin:**

- Jane punesuar punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialist te profesioneve qe kerkohen.
- Jane punesuar punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.
- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menyrat per parandalimin e tyre.
- Punonjesit pajisjen me mjete mbrojtese si dhe uniformat perkatese,
- Do te instruktohen punonjesit ne menyre periodike.

#### ➤ **Detyrat e punonjesve:**

- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.
- Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjeve ne perdomim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt te tyre fillon punen.
- Kur konstaton difikte dhe nuk eshte ne gjendje ta eleminoje ndalon punen dhe ve ne dijeni perjegjesin me te afert.
- Te perdore mjetet individuale te mbrojtjes gjate punes.